



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 26, Datë 30.01.2018**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGJI ASHTA” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E  
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “ç” dhe 39 pika 3, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 4, pika 1, gërma “d”; nenit 5, pika 1, gërma “d”, nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimit Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën nr.714 prot, datë 02.11.2017, shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., ka paraqitur në ERE, një kërkesë për licencim në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
- Subjekti me shkresën (plotësim dokumentacioni) të protokolluar në ERE me nr.714/2 prot, datë 12.12.2017, ka depozituar statutin e ndryshuar dhe ekstraktin e shoqërisë, që bën me dije se, objekti i veprimtarisë së shoqërisë ka ndryshuar duke shtuar në të aktivitetin e furnizimit me energji elektrike, i cili nuk ka qënë i pasqyruar në dokumentacionin e aplikimit nr.714 prot, datë 02.11.2017.
- Me Vendimin nr. 205, datë 18.12.2017, ERE ka filluar procedurat për licencimin e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b” “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “Energji Ashta” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 (pesë) – vjeçar, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi, mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit AHMETI**